Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarna Izborna Komisija
Central Election Commission
18 -03- 2021
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 324-2021

Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 4.6 të Rregullës së KQZ nr. 01/2013 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 18.03.2021, merr këtë:

V E N D I M

Për regjistrimin e Partisë Politike Partia Republikane për Ndryshime-PRN

I. Regjistrohet Partia Politike "Partia Republikane për Ndryshime" me akronim PRN, me kryetar z. Ismet Krasniqi.

II. Partia Politike Partia Republikane për Ndryshime – PRN, i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe obligimet e përcaktuara me nenet 3 dhe 4 të Rregullës zgjedhore 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

III. Partia Politike Partia Republikane për Ndryshime – PRN, obligohet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin në bazë nenit 15 të Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

IV. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta përgatit certifikatën e regjistrimit dhe ta regjistroj Partinë Politike Partia Republikane për Ndryshime – PRN në Regjistrin e Partive Politike të Kosovës.

V. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta njoftoj partinë politike Partia Republikane për Ndryshime – PRN, për marrjen e këtij Vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjitha palët që kanë interes juridik kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.